

Njoftim publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05 Nr. 350/02-101151/22 dt. 10.05.2022, në emër të aplikuesit Nebih Azemi me adresë në rr. Besim Ndreca”, Çagllavicë, Prishtinë, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kritere të caktuara për ndërtim, përkatësisht për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin e ndërtesës me karakter të përkohshëm – depo për ruajtjen e paletave, me etazhitet P+0, në kuadër të parcelës ndërtimore “L-40/3-8”, të bllokut urban “L-40/3”, të tërësisë hapësinore “L”, në kuadër të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1251-3; ZK Çagllavicë.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data **18.05.2022** deri më **22.05.2022**, në e-mail adresat: urbanizmi@rks-gov.net; marigona.gashi@rks-gov.net

Kushtet e propozuara të ndërtimit:	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Ndërtesë me karakter të përkohshëm – depo për ruajtjen e paletave, me etazhitet P+0
b. Vija rregulluese	Kufiri i parcelës kadastrale / Rruga e planifikuar
c. Vija ndërtimore	12.65 m' nga vija rregulluese
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	4.00m' / vija ndërtimore
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	4.00 m'/min. 2.90m' – veri 4.00 m'/ min. 3.00 m' – jug 4.00 m'/ min. 3.00 m' – perëndim
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	40% e lejuar sipas Rregullores ~ 29.82% e propozuar
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN)	P+0 e lejuar sipas Rregullores P+0 e propozuar
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	Min. 40% e lejuar sipas Rregullores ~ 55.35% e propozuar
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	/
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	Minimum 1-VP për një njësi banimi
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - <input checked="" type="checkbox"/> Jo - <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/>	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe sesa zona përreth? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në zona të mbrojtura, zona të veçanta ose zona të veçanta të mbrojtura? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 06/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigje njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës. Në të gjitha komentet tuaja duhet të përshkruhet numri i kërkesës të shënuar më lartë.

